



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT

Raport Monitorues

mbi punën e legjislativit
të Komunës së Lipjanit

2024

Janar - Qershor

COPYRIGHT © 2024. Youth Association for Human Rights (YAHR).

Youth Association for Human Rights i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura. Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rruga Tahir Sinani,
14000, Lipjan,
Kosovë
Tel.: +383 (0) 44 786 414
E-mail: info.yahr@gmail.com
Web: www.yahr-ks.org

Autor: Bekim Krasniqi

Asistentë të hulumtimit: Bekim Krasniqi
Faqësja dhe dizajni: YAHR

Ky publikim është përgatitur nga Youth Association for Human Rights dhe përkrahur nga granti të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	3
Lista e Tableave	3
Hyrje	4
Përmbledhje ekzekutive	5
Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendeve Komunale	7
Dinamika e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit	7
Lista e rregulloreve dhe planeve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2023:	9
Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2023:	9
Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë periudhës Janar - Qershor 2024:	9
Pyetje parlamentare	13
Inicimi i çështjeve	14
Burimet:	16

LISTA E SHKURTESAVE

AAK	ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
AKR	ALEANCA KOSOVA E RE
DCC	DEMOKRTASKA STRANKA
LB	LËVIZJA PËR BASHKIM
LDD	ALEANCA KOSOVA E RE
LDK	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
LVV	LËVIZJA VETËVENDOSJE
KK	KUVENDI KOMUNAL
PAI	PARTIA ASHKALIVE PËR INTEGRIM
PD	PARTIA E DREJTËSISË
PDAK	PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALIVE TË KOSOVËS
PDK	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
PLE	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE
PSD	PARTIA SOCIAL DEMOKRATE
YAHR	YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS

LISTA E TABLEAVE

Tabela 1: Aktiviteti i Kuvendet gjatë 2023	6
Tabela 2: Renditja e Kuvendareve bazuar në angazhimet e tyre nëpër seanca plenare të Kuvendit të Lipjanit	8
Tabela 3: Pjesëmarrja e subjekteve politike gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	11
Tabela 4: Pjesëmarrja e Kuvendareve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	12
Tabela 5: Pjesëmarrja e subjekteve politike në pyetjeve parlamentare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	13
Tabela 6: Pjesëmarrja e subjekteve politike në Inicimi i çështjeve në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	

HYRJE

Të nderuar qytetarë të Komunës së Lipjanit,

Me këtë shkrim dëshirojmë të ju njoftojmë për vazhdimin e angazhimit të organizatës joqeveritare Youth Association for Human Rights (YAHR) në monitorimin e aktiviteteve të legjislativit në Komunën e Lipjanit dhe në Komunën e Shtimes, gjatë periudhës së ardhshme katër vjeçare 2025-2029. YAHR do të vazhdojë të publikojë raporte monitoruese-vlerësuese çdo gjashtë muaj, duke siguruar transparencë dhe informacion të strukturuar për qytetarët, shoqërinë civile, mediat, si dhe për Kuvendin e Komunës së Lipjanit dhe Shtimes.

YAHR ka qenë aktiv në monitorimin proaktiv të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit që nga viti 2009 dhe të Komunës së Shtimes që nga viti 2019. Përmes raporteve monitoruese, ne synojmë të kontribuojmë në përmirësimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës së proceseve vendimmarrëse, duke ofruar një analizë të hollësishme të zhvillimeve dhe veprimeve të kuvendarëve dhe institucioneve lokale.

Raporti monitorues për punën e legjislativit të Komunës së Lipjanit do të karakterizohet nga informacione të rëndësishme dhe zhvillime interesante që kanë ndodhur gjatë periudhës së monitorimit. Ne kemi përdorur një gamë të gjerë burimesh informative për hartimin e këtij raporti, duke përfshirë:

- Monitorimin e seancave të Kuvendeve Komunale dhe komitetit për Politikë dhe Financa.
- Analizimin e dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rende të ditës.
- Studimin e raporteve të mediave të shkruara dhe elektronike.
- Analizimin e debateteve dhe diskutimeve të organizuara nga shoqëria civile dhe të tjera.

Me këtë angazhim, ne synojmë të sigurojmë që proceset vendimmarrëse në Komunën e Lipjanit të jenë transparente dhe të përputhshme me nevojat dhe interesat e komunitetit tonë lokal. Nëse keni çfarëdo pyetje apo sugjerimesh, jemi të hapur për dialog dhe bashkëpunim.

Me respekt,

Bekim Krasniqi
Drejtor Ekzekutiv i YAHR-it

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2024, organizata e shoqërisë civile Youth Association for Human Rights (YAHR) ka zhvilluar një monitorim të detajuar të punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit, me qëllim të vlerësimit të performancës së kuvendarëve si përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve. Monitorimi është bazuar në aktivitetet e seancave plenare dhe ndërveprimin e kuvendarëve me ekzekutivin komunal, duke identifikuar dhe vlerësuar angazhimin dhe pjesëmarrjen e tyre në diskutime, ngritjen e çështjeve dhe pyetjeve drejtuar për shqyrtimin e çështjeve të ndryshme.

Në total, gjatë kësaj periudhe, Kuvendi Komunal i Lipjanit zhvilloi 6 seanca plenare. Në këto seanca, u aprovuan një sërë vendimesh (27 në total), një rregullore ose plan komunal dhe u shqyrtuan 7 raporte dhe informacione të paraqitura nga ekzekutivi komunal. Këto procese tregojnë pjesëmarrjen dhe aftësinë e Kuvendit për të kryer detyrat e saj ligjore dhe për të mbështetur zhvillimin e komunitetit lokal.

Bazuar në vlerësimin e bërë nga YAHR, disa kuvendarë dalin në pah për angazhimin e tyre të lartë dhe kontributin në punën e Kuvendit Komunal:

- **Arsim Jashari** nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka arritur 265 pikë, duke e bërë atë kuvendarin më aktiv gjatë periudhës. Pjesëmarrja e tij e shpeshtë në diskutime dhe kontributi në ngritjen e çështjeve kanë shërbyer si një model i prezencës aktive dhe përkushtimit në zbatimin e detyrave kuvendore.
- **Lulzim Rustemi**, gjithashtu nga PDK, ka fituar 155 pikë, ndërsa **Egzona Bytyqi** nga PDK ka arritur 154 pikë, treguar një pjesëmarrje dhe kontribut të rëndësishëm në punën e Kuvendit.

Këta kuvendarë janë vlerësuar për iniciativën e tyre në ngritjen e çështjeve dhe pyetjeve të rëndësishme për ekzekutivin komunal, duke ndihmuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në administratën lokale.

Në anën tjetër, disa kuvendarë kanë shfaqur një pjesëmarrje më të kufizuar dhe nuk kanë arritur të përfaqësojnë një prezencë aktive në seancat plenare të Kuvendit. Kjo përfshin emra si **Shefki Bytyqi**, **Shkelzim Olluri**, **Fadil Sopa**, **Venhar Agushi**, **Sami Bytyqi**, **Fitim Shala**, **Xhyzide Rustemi** nga LDK-ja dhe **Fatmir Fetahu** nga LVV-ja, të cilët kanë fituar zero pikë për mungesë të aktivitetit në diskutime dhe angazhimin e kërkuar përfaqësues në proceset ligjore lokale.

Përveç kësaj, **Majlinda Sylejmani** nga LDK-ja ka pësuar penalizim me -5 pikë për mungesën e prezencës në seancat plenare të Kuvendit, e cila është regjistruar dhe vlerësuar nga monitoruesit e YAHR.


Nga ana tjetër, analiza e pjesëmarrjes së partive politike në diskutime tregon se PDK-ja ka qenë më e angazhuar, me 60 diskutime ose 44.78% të pjesëmarrjes totale, ndjekur nga LVV-ja me 48 diskutime ose 35.82% dhe LDK-ja me 24 diskutime ose 17.91%. AAK-ja dhe PAI nuk kanë shfaqur pjesëmarrje të shënuar në diskutime gjatë kësaj periudhe.

Ky vlerësim i detajuar i performancës së kuvendarëve dhe subjekteve politike në Kuvendin Komunal të Lipjanit ofron një përshtypje të qartë mbi pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre në përfaqësimin e qytetarëve dhe në zbatimin e detyrave të tyre ligjore. Monitorimi i bërë nga YAHR sjell një ndriçim të rëndësishëm mbi përgjegjshmërinë dhe efikasitetin e institucionit lokal në shërbim të komunitetit të Lipjanit.

Tabela 1. Aktiviteti i Kuvendeve Komunave gjatë periudhës Janar - Qershor 2024

Komuna	Nr. i vendimeve të aprovuara	Nr. i raporteve / informata të shqyrtuara	Nr. i Rregulloreve të miratuara
Lipjan	27	8	1

Aktiviteti i Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë periudhës së parë të vitit 2024



QËLLIMET E MONITORIMI TË PUNËS SË KUVENDEVE KOMUNALE

Qëllimet e monitorimit të punës së kuvendeve komunale nga organizata shoqërore Youth Association for Human Rights (YAHR) kanë një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës së proceseve vendimmarrëse në nivel lokal. Këto qëllime përfshijnë:

1. **Adresimi i interesave dhe brengave të qytetarëve:** YAHR synon të përfaqësojë dhe të adresojë interesat e përgjithshme të qytetarëve të Lipjanit në mënyrë të paanshme dhe jo-partiake. Përmes monitorimit të punës së kuvendarëve komunalë, organizata punon për të siguruar që çështjet e rëndësishme për komunitetin të trajtohen dhe të diskutohen në mënyrë transparente dhe në përputhje me nevojat e qytetarëve.
2. **Ofrimi i informacionit të vazhdueshëm:** YAHR angazhohet të sigurojë që qytetarët të kenë qasje në informacionin e plotë dhe të rregullt lidhur me punën dhe vendimet e Kuvendit Komunal të Lipjanit. Kjo përfshin monitorimin e seancave plenare, diskutimet, vendimet e miratuara, si dhe çështjet e ngritura dhe pyetjet e drejtuar drejtuesve ekzekutiv.
3. **Ndërtimi i shoqërisë së qëndrueshme demokratike:** Qëllimi kryesor i monitorimit të punës së kuvendeve komunale është të kontribuojë në forcimin e sistemit demokratik në Kosovë, duke promovuar llogaridhënien, transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Përmes vlerësimit të performancës së kuvendarëve, YAHR synon të inkurajojë një mjedis ku përgjegjshmëria dhe integriteti janë vlera themelore të administratës publike lokale.

Këto qëllime përbëjnë një pjesë të strategjisë së YAHR për të siguruar që institucionet lokale të qeverisjes funksionojnë në mënyrë të përshtatshme dhe të përmbushin standardet e përgjegjshmërisë publike, duke i bërë ato më të qasshme dhe të përgjegjshme ndaj komunitetit lokal.

DINAMIKA E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2024, aktiviteti i kuvendarëve në Kuvendin Komunal të Lipjanit ka qenë i shumëllojshëm dhe i ndryshueshëm. Disa kuvendarë kanë shquar për prezencën dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm në seancat plenare dhe punën e komisioneve të ndryshme. Këtu janë kuvendarët më aktivë dhe ata më pasivë sipas pikëve të mbledhura: Arsim Jashari PDK 265 pikë, Lulzim

Rrustemi PDK 155 pikë, Egzona Bytyqi PDK 154 pikë, Shahadije Dragacina LVV 130 pikë, Besiana Sylja LVV 106 pikë, Lumturije Bytyqi Hasani PDK 103 pikë, Fadil Spahiu LVV 103 pikë, Rinor Murati LDK 85 pikë, Ardit Cani PDK 84 pikë, Alban Salihu LVV 79 pikë, Albiona Tasholli LDK 59 pikë, Herolind Kozhani PDK 55 pikë, Ganimete Qeriqi PDK 30 pikë, Bashkim Budakova AAK 18 pikë, Fitim Meziu LVV 16 pikë, Nexhmedin Lekiqi LDK 12 pikë, Gentiane Hoxhaj LDK 11 pikë, Armend Grajcevci LDK 10 pikë, Gazmend Qerkini LDK 8 pikë, Enver Kryeziu PAI 5 pikë dhe Xhyla Dedushaj Rexhepi LDK 1 pikë. Kuvendaret më pasiv janë: Shefki Bytyqi, Shkelzim Olluri , Fadil Sopa , Venhar Agushi , Sami Bytyqi , Fitim Shala, Xhyzide Rrustemi nga LDK-ja dhe Fatmir Fetahu nga LVV-ja me asnjë pikë gjatë periudhës Janar - Qershor 2024. Ndërsa Majlinda Sylejmani nga LDK me -5 pikë për shkak të mungesave të prezencës së saj në seanca plenare të kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Tabela 2: Renditja e Kuvendareve bazuar në angazhimet e tyre nga seanca plenare 26-31 e Kuvendit të Lipjanit

	Kuvendari	Subjekti politikë	pikët		Kuvendari	Subjekti politikë	pikët
1	Arsim Jashari	PDK	265	16	Nexhmedin Lekiqi	LDK	12
2	Lulzim Rrustemi	PDK	155	17	Gentiane Hoxhaj	LDK	11
3	Egzona Bytyqi	PDK	154	18	Armend Grajcevci	LDK	10
4	Shahadije Dragacina	LVV	130	19	Gazmend Qerkini	LDK	8
5	Besiana Sylja	LVV	106	20	Enver Kryeziu	PAI	5
6	Lumturije Bytyqi Hasani	PDK	103	21	Xhyla Dedushaj Rexhepi	LDK	1
7	Fadil Spahiu	LVV	103	22	Shefki Bytyqi	LDK	0
8	Rinor Murati	LDK	85	23	Shkelzim Olluri	LDK	0
9	Ardit Cani	PDK	84	24	Fadil Sopa	LDK	0
10	Alban Salihu	LVV	79	25	Venhar Agushi	LDK	0
11	Albiona Tasholli	LDK	59	26	Sami Bytyqi	LDK	0
12	Herolind Kozhani	PDK	55	27	Fitim Shala	LDK	0
13	Ganimete Qeriqi	PDK	30	28	Xhyzide Rrustemi	LDK	0
14	Bashkim Budakova	AAK	18	29	Fatmir Fetahu	LVV	0
15	Fitim Meziu	LVV	16	30	Majlinda Sylejmani	LDK	-5

LISTA E RREGULLOREVE DHE PLANEVE TË SHQYRTUARA NGA KUVENDI KOMUNAL TË VITIT 2023:

- Propozim Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Mehdi Zejnullahu" në Lipjan.

LISTA E RAPORTEVE TË SHQYRTUARA NGA KUVENDI KOMUNAL TË VITIT 2023:

- Raporti i shpenzimeve dhe te hyrave Janar Dhjetor 2023
- Raport Financiar i KRM "PASTRIMI" SH.A për njësinë Operative te Lipjanit për vitin 2023
- Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023
- Raporti i përformancës së komunës së Lipjanit për vitin 2022
- Raporti, Janar-Dhjetor 2023, i punës së zyrës se Kryetarit dhe drejtorateve komunale
- Informatë për punën e KKS-së për vitin 2023.
- Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar- Mars 2024.
- Informatë lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031.

LISTA E VENDIMEVE KOMUNALE TË MIRATUAR GJATË PERIUDHËS JANAR - QERSHOR 2024:

- Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social
- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të kryetareve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të komunës së Lipjanit
- Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2023-2027
- Vendim për miratimin e marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit ndër komunal shumë-funksional
- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për islamik Relief Worldwide- Zyra në Kosovë (IRW)
- vendim për miratimin e raportit te komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në komunën e Lipjanit për vitin 2023
- Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2024-2028
- Vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit për barazinë gjinore 2024-2026.
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, ZK Grackë e Vjetër.
- Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Grackë e Vjetër.
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, ZK Lipjan.
- Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.
- Vendim për formimin e Komisionit të Ankesave.
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer për subvencionimin e qumështit.
- Vendim për rritjen e buxhetit të komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2023

- Vendim për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2024-2026 i Komunës së Lipjanit.
- Vendim për korigjimin e vendimit paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK-Lipjan 15Nr.463/02-17208 të miratuar më datën 29.03.2024.
- Vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve.
- Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.
- Vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali i Komunës së Lipjanit (2024-2026).
- Propozim Vendimi mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.
- Propozim Vendimi mbi rialokimin e mjeteve buxhetore të mbetura nga të hyrat vetanake.
- Propozim Vendimi për miratimin e Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026.
- Propozim Vendimi për miratimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Lipjanit 2024-2027.
- Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – Strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.
- Propozim Vendimi për aprovimin e rezervës komunale.

Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2024 në Kuvendin Komunal të Lipjanit, subjektet politike kanë qenë të përfshira aktivisht në debatet dhe diskutimet e rregullta. Analiza e pjesëmarrjes së tyre tregon se partitë opozitare kanë pasur një prezencë dominuese. Përfaqësimi i tyre është shpërndarë si më poshtë:

1. **Partia Demokratike e Kosovës (PDK)** ka qenë subjekti politik më i shpeshtë në debatet e Kuvendit Komunal të Lipjanit, duke zhvilluar 60 diskutime, ose përqindje të pjesëmarrjes prej 44.78%. Kjo tregon një angazhim të fortë të PDK-së në çështjet lokale dhe debatet e komunitetit.
2. **Lëvizja Vetëvendosje (LVV)** ka ndjekur në krye, me 48 diskutime të zhvilluara, që përfaqësojnë 35.82% të pjesëmarrjes. LVV vazhdon të jetë një forcë e rëndësishme politike në Lipjan.
3. **Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)** është e treta në numër të diskutimeve me 24 sesione, ose 17.91% të pjesëmarrjes. LDK vazhdon të ketë një prezencë të rëndësishme në debatet komunale.
4. **Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)** përfshin veten me vetëm 2 diskutime, që përfaqësojnë 1.49% të pjesëmarrjes. Edhe pse me një prezencë më të ulët në numër të diskutimeve, AAK mbetet e përfshirë në dialogun politik të Lipjanit.

5. **Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI)** nuk ka pasur asnjë diskutim të zhvilluar në periudhën e përmendur, duke treguar një mungesë të vazhdueshme të aktivitetit në Kuvendin Komunal të Lipjanit.

Pjesëmarrja e këtyre subjekteve politike tregon një skenë të zhvilluar debatike dhe angazhim të ndryshëm në temat e rëndësishme komunale për qytetarët e Lipjanit gjatë gjysmës së parë të vitit 2024.

Tabela 3: Pjesëmarrja e subjekteve politike gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

Subjekti politik	Propozim për rend dite			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave			Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve			Inicimi i çështjeve			Pyetjet parlamentare			Mungesa në seanca		
	Disk.	%		Disk.	%		Disk.	%		Inic.	%		Pyet.	%		Mung.		
LDK	0	0.00	%	24	17.91	%	5	35.71	%	10	6.67	%	7	18.92	%	6	75	%
PDK	1	33.33	%	60	44.78	%	9	64.29	%	99	66.00	%	20	54.05	%	0	0	%
LVV	1	33.33	%	48	35.82	%	0	0.00	%	39	26.00	%	9	24.32	%	0	0	%
AAK	0	0.00	%	2	1.49	%	0	0.00	%	2	1.33	%	0	0.00	%	0	0	%
PAI	1	33.33	%	0	0.00		0	0.00		0	0.00		1	2.70		2	25	




Tabela 4: Pjesëmarrja e Kuvendareve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT		Propozim për rend dite	Pjesëmarja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamentimi i legjislacionit	Inicimi I rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
Deputetët	Subjekti politik										
Nexhmedin Lekiqi	LDK	0	12	0	0	0	0	0	0	0	12
Majlinda Sylejmani	LDK	0	0	0	0	0	0	0	-5	0	-5
Shefki Bytyqi	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gazmend Qerkini	LDK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	8
Shkelzim Olluri	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Albiona Tasholli	LDK	0	28	1	20	0	0	10	0	0	59
Fadil Sopa	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gentiane Hoxhaj	LDK	0	4	2	0	0	0	5	0	0	11
Venhar Agushi	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Xhyla Dedushaj Rexhepi	LDK	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Sami Bytyqi	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fitim Shala	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Xhyzide Rustemi	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Rinor Murati	LDK	0	40	0	30	0	0	15	0	0	85
Armend Grajcevci	LDK	0	4	1	0	0	0	5	0	0	10
Lulzim Rustemi	PDK	2	48	0	90	0	0	15	0	0	155
Herolind Kozhani	PDK	0	4	1	25	0	0	25	0	0	55
Ardit Cani	PDK	0	8	1	75	0	0	0	0	0	84
Arsim Jashari	PDK	0	80	5	145	0	0	35	0	0	265
Egzona Bytyqi	PDK	0	48	1	95	0	0	10	0	0	154
Lumturije Bytyqi Hasani	PDK	0	48	0	45	0	0	10	0	0	103
Ganimete Qeriqi	PDK	0	4	1	20	0	0	5	0	0	30
Alban Salihu	LVV	0	44	0	30	0	0	5	0	0	79
Fitim Meziu	LVV	0	16	0	0	0	0	0	0	0	16
Fadil Spahiu	LVV	2	36	0	55	0	0	10	0	0	103
Fatmir Fetahu	LVV	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shahadije Dragacina	LVV	0	40	0	70	0	0	20	0	0	130
Besiana Sylja	LVV	0	56	0	40	0	0	10	0	0	106
Bashkim Budakova	AAK	0	8	0	10	0	0	0	0	0	18
Enver Kryeziu	PAI	2	0	0	0	0	0	5	-2	0	5

PYETJE PARLAMENTARE


Gjatë periudhës Janar-Qershor 2024, Kuvendi Komunal i Lipjanit ka qenë një arenë e shquar për diskutime dhe pyetje ndaj ekzekutivit lokal, ku subjektet politike kanë shfaqur një angazhim të dukshëm. Në këtë kohë, analiza e pjesëmarrjes së tyre në parashtrimin e pyetjeve tregon një pikturë të qartë të aktivitetit politik në nivel lokal:

1. **Partia Demokratike e Kosovës (PDK)** ka qenë subjekti politik më aktiv me 20 pyetje të ngritura, që përfaqësojnë 54.05% të pyetjeve të drejtuar drejt ekzekutivit komunal. Kjo tregon një qëndrim të fortë të PDK-së në monitorimin dhe kritikën e veprimeve të qeverisë lokale në Lipjan.
2. **Lëvizja Vetëvendosje (LVV)** vijon me 9 pyetje të ngritura, që përbëjnë 24.32% të totalit të pyetjeve. LVV, si një subjekt i rëndësishëm opozitar në Kuvendin e Lipjanit.
3. **Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)** ka kontribuar me 7 pyetje, ose 18.92% të pjesëmarrjes në parashtrimin e pyetjeve. LDK vazhdon të jetë një aktor i rëndësishëm në dialogun politik lokal, duke shprehur shqetësime dhe duke kërkuar llogari nga ekzekutivi për veprimet e tyre.
4. **Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI)** ka shfaqur një prezencë më të ulët me vetëm 1 pyetje të ngritur, që përmban 2.70% të totalit të pyetjeve. Megjithatë, PAI ka shfaqur interes dhe pjesëmarrje në diskutimet rreth çështjeve të ndryshme qytetare dhe komunale në Lipjan.

Kjo analizë tregon se Kuvendi Komunal i Lipjanit është një forum i rëndësishëm për kontrollin dhe pjesëmarrjen e partive politike në qeverisjen lokale. Diskutimet dhe pyetjet e ngritura reflektojnë angazhimin e partive për të siguruar llogaridhënie dhe për të ndikuar në politikat lokale për mirëqenien dhe zhvillimin e komunitetit të Lipjanit

Tabela 5: Pjesëmarrja e subjekteve politike në pyetjeve parlamentare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

Subjekti politik	Pyetjet parlamentare		
	Pyetje	%	
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	7	18.92	%
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	20	54.05	%
LËVIZJA VETËVENDOSJE	9	24.32	%
ALEANCA PËR ARDHMERINË E KOSOVËS	0	0.00	%
PARTIA ASHKALINJVE PËR INTERGRIM	1	2.70	%



INICIMI I ÇËSHTJEVE


Gjatë periudhës Janar-Qershor 2024, Kuvendi Komunal i Lipjanit ka shënuar një aktivitet të rëndësishëm në ngritjen e çështjeve dhe problematikave të ndryshme nga kuvendarët. Analiza e pjesëmarrjes së subjekteve politike tregon se disa prej tyre kanë qenë shumë të angazhuara në këtë proces:

1. **Partia Demokratike e Kosovës (PDK)** ka qenë subjekti më aktiv me 99 çështje të ngritura, që përfaqësojnë një pjesëmarrje të shkëlqyer prej 66% të totalit të çështjeve të ngritura nga kuvendarët. PDK ka zënë pozitën udhëheqëse në adresimin e sfidave dhe çështjeve të rëndësishme komunale në Lipjan gjatë kësaj periudhe.
2. **Lëvizja Vetëvendosje (LVV)** ka shfaqur një pjesëmarrje të rëndësishme me 39 çështje të ngritura, që përbëjnë 26% të totalit. LVV vazhdon të jetë një forcë e rëndësishme opozitare, duke kontribuar në diskutimin dhe propozimet për përmirësimin e gjendjes së qytetarëve në Lipjan.
3. **Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)** ka ngritur 10 çështje, duke përfaqësuar 6.67% të pjesëmarrjes së kuvendarëve në ngritjen e çështjeve. LDK ka qenë aktive në adresimin e çështjeve të rëndësishme lokale dhe në ofrimin e alternativave për politikat vendore.
4. **Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)** ka kontribuar me 2 çështje të ngritura, që përmbajnë 1.33% të totalit. Edhe pse me një pjesëmarrje më të ulët në numrin e çështjeve të ngritura, AAK ka qenë pjesë e dialogut dhe diskutimeve për sfidat dhe mundësitë në Lipjan.

Këto të dhëna tregojnë se Kuvendi Komunal i Lipjanit ka pasur një proces të shëndoshë debati dhe pjesëmarrjeje nga subjektet politike, duke shfaqur një angazhim të vazhdueshëm për të përmirësuar jetën komunale dhe për të ndikuar në politikat vendore në përputhje me interesat e qytetarëve të Lipjanit

Tabela 6: Pjesëmarrja e subjekteve politike në Inicimi i çështjeve në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

Subjekti politik	Inicimi i çështjeve		
	Inicime	%	
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	10	6.67	%
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	99	66.00	%
LËVIZJA VETËVENDOSJE	39	26.00	%
ALEANCA PËR ARDHMERINË E KOSOVËS	2	1.33	%
PARTIA ASHKALINJVE PËR INTERGRIM	0	0.00	%



BURIMET:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. 2024.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, r2024
3. <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>
4. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, ..
5. Komunikatat për media të YAHR-it 2024.
6. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal të Lipjanit 2024,
7. <http://kk.rks-gov.net/Lipjan/>
8. <https://www.youtube.com/channel/UCmDXxB6d1n6gXGtEiowljQQ>

2024